

URDHËR
Nr. 546, datë 30.5.2025

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 101, DATË 31.1.2025, “PËR
DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E GJERMANISË”;**

**URDHËRIT NR. 78, DATË 29.1.2025, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E
KOSOVËS”;**

**URDHËRIT NR. 165, DATË 21.2.2025, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E
SLLOVENISË”;**

**URDHËRIT NR. 274, DATË 21.3.2025, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E
MAQEDONISË SË VERIUT”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe pikës 3, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e:
 - urdhrit nr. 101, datë 31.1.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”;
 - urdhrit nr. 78, datë 29.1.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Kosovës”;
 - urdhrit nr. 165, datë 21.2.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Sllovenisë”;
 - urdhrit nr. 274, datë 21.3.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Maqedonisë së Veriut”.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj